



**REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVO CUMHURIYETI**

---

**C.nr.411/12**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Arsim Hamzaj, me sekretaren juridike Majlinda Shala, në kontestin e paditësit Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. – Distrikti në Prizren, kundër të paditurit Sh. D. nga Prizreni, për shkak të borxhit, vlera e kontestit 4,777.36 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 03.02.2015, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia** e paditësit KEK – Distrikti në Prizren dhe **obligohet** i padituri Sh. D. nga Prizreni, që paditësit në emër të borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike t'ia paguajë shumën prej **1,298.70 euro**, me kamatë vjetore 3.5 %, duke iu llogaritur pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive.

**II.** Obligohet i padituri që shumën nga pika **I** e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë paditësit në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**III.** Pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit KEK – Distrikti në Prizren mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin nën **I** të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e përgjithshme të kërkuar prej **4,777.36 euro**, **refuzohet si e pabazuar**.

**IV.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Tani paditësi (ish kreditori) Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. – Distrikti në Prizren, me datën 10.09.2008, pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozim për përmbarim në bazë të dokumentit autentik, kundër tani të paditurit (ish debitorit) Sh. D. nga Prizreni, për shkak të pagesës së borxhit. Me datën 15.09.2008, gjykata ka marr aktvendimin E.nr.1917/08, për caktimin e përmbarimit të propozuar.

Kundër Aktvendimit për përmbarim E.nr.1917/08, të datës 15.09.2008, i padituri (ish debitori) Sh. D. nga Prizreni, kishte parashtruar kundërshtim, duke e atakuar të njëjtin me arsyetimin se nuk ka harxhuar kaq shumë rrymë, pasi që objekti është i pa

banueshëm që nga viti 2004, dhe duke shtuar se të njëjtat edhe janë vjetërsuar, me propozim që kundërshtimi i tij të aprovohet dhe që aktvendimi i atakuar të lihet jashtë fuqie, si dhe duke propozuar pezullimin e ekzekutimit të caktuar me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren E.nr. 1917/08, të datës 15.09.2008.

Duke vendosur sipas kundërshtimit të të paditurit (ish debitorit), me datën 24.02.2012, kjo gjykatë në procedurë përmbartimore ka marrë aktvendimin përmes të cilit është shfuqizuar aktvendimi për lejim të përmbartimit E.nr. 1917/08, të datës 15.09.2008, ndërsa që propozimi për ekzekutim i kreditorit, është konsideruar padi.

Seanca e shqyrtimit kryesor për këtë çështje juridiko kontestimore është mbajtur me datën 03.02.2015.

Në këtë seancë, i autorizuari i paditësit Bekim Parallangaj ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa në fjalën e tij të fundit ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe ta obligoj të paditurin që në emër të borxhit, t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 4,777.36 eurove si dhe shpenzimet e procedurës, për të cilat nuk është specifikuar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, i padituri Sh. D. nga Prizreni, ka deklaruar se mbetet pranë kundërshtimit të datës 25.11.2011 duke kërkuar nga gjykata refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazë, ndërsa në fjalën e tij të fundit ka theksuar se nga provat e administruara nuk është vërtetuar as baza e as lartësia e kërkesëpadisë së paditësit, andaj dhe ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të tjera, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

**Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.**

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat e propozuara si në vijim: Faturën nr.4649712, të datës 08.08.2008, të lëshuar nga KEK – Prizren si dhe Transaksionet e konsumatorit të lëshuar nga KEDS-Prizren, të datës 14.01.2015.

Nga leximi i Faturën nr.4649712, të datës 08.08.2008, të lëshuar nga KEK – Prizren, gjykata ka konstatuar se të gjitha këto fatura janë lëshuar në emër të këtu të paditurit Sh. D. nga Prizreni dhe se sipas kësaj fature, ky borxh del të jetë në shumën prej 4,814.34 euro.

Nga leximi i transaksioneve të konsumatorit të lëshuar nga KEDS - Prizren, të datës 14.01.2015, gjykata ka konstatuar se borxhi i përgjithshëm i këtu të paditurit është në shumën prej 6,586.89 euro.

Me nenin 17 Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është e paraparë se *“pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se *“kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë*

*përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”. Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se “ palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla ...”.*

Sipas dispozitave të nenit 378 par.1 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se parashkruhen për një vjet:

*“- a) kërkesat e kompenzimit për livrimin e **energjisë elektrike** e të ngrohjes, ujit, gazit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi respektivisht shërbimi është kryer për nevoja shtëpiake.*

*- b) kërkesat e radiostacionit dhe të stacionit të radiotelevizionit për përdorimin e aparatit të radios dhe të aparatit televiziv.*

*- c) kërkesat e postës, telegrafit e të telefonave për përdorimin e telefonit e të aparateve postare si dhe kërkesat tjera të tyre që arkëtohen në afatet tremujore apo më të shkurtëra.*

*- ç) kërkesat e parapagimit në botimin periodik, duke llogaritur nga skadimi i kohës për të cilin është porositur botimi”.*

Ndërsa në par. 2 parashihet se “*parashkrimi rrjedh megjithëse livrimet apo shërbimet janë zgjatur*”.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet pjesërisht. Kjo ngase në bazë të provave të administruara del se ky borxh evidentohet në emër të të paditurit Sh. D., gjegjësisht është provuar se këtu i padituri ka detyrime-borxh, ndaj paditësit Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. – Distrikti në Prizren për shfrytëzimin e energjisë elektrike prej muajit Shtator 2007 deri në muajin Gusht 2008, andaj dhe vendosi si në pikën **I** dhe **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Pjesën tjetër të kërkesëpadiës së paditësit përtej shumës së aprovuar, gjykata refuzoi, ngase gjeti se e njëjta është e pa bazuar. Gjkata ka vlerësuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë të parashkruar pasi që sipas transaksionit të konsumatorit të cilin kjo gjykatë i ka administruar në cilësi të provës, është konstatuar se borxhi i të paditurit i kërkuar nga ana e paditësit për periudhën deri në muajin Gusht 2007 ka arritur për pagesë me datën 31.08.2007 respektivisht 01.09.2007, ndërsa paditësi (ish kreditori) e ka parashtruar propozimin për ekzekutim me datën 10.09.2008 që do të thotë pas kalimit të afatit një vjeçar brenda të cilit ka qenë i detyruar që i padituri (ish debitori) të paguajë borxhin. Përfundimisht gjykata vlerësoi se në rastin konkret natyra e shërbimeve të ofruara karakterizohet në grupin e kërkesave të cilat parashkruhen në afatin një vjeçar në kuptim të dispozitave të nenit 378 të LMD-së, andaj dhe vendosi si në pikën **III** të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjkata pretendimet e të paditurit të dhëna në seancën e datës 15.01.2015 se ai nuk e ka shfrytëzuar lokalin dhe se nuk e din se si është regjistruar ora në emër të tij, i vlerësoi si të paqëndrueshme, pasi që të njëjtat janë në kundërshtim me provat e administruara dhe i padituri për këtë nuk ka ofruar asnjë provë në seancën e shqyrtimit kryesor edhe pse është ftuar për këtë, dhe *barra e të provuarit* lidhur me pretendimet (kundërshtimet) e theksuara i ka takuar atij.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 449 dhe 452.4 të LPK-së. pasi që i autorizuari i paditësit i ka kërkuar shpenzimet por nuk i ka specifikuar, ndërsa i padituri nuk i ka kërkuar.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.411/12, datë 03.02.2015**

Sekretarja juridike  
Majlinda Shala

**Gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.